

VENDIM
Nr. 403, datë 3.5.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI URBAN I SHESHEVE TË FSHATRAVE ALLAMBREZ, CUKALAT, KUTALLI DHE POSHNJE”, URA VAJGURE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi urban i shesheve të fshatrave Allambrez, Cukalat, Kutalli dhe Poshnje”, Ura Vajgure.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Ura Vajgure.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë “truall” dhe “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 751 100 (shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 751 100 (shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind) lekësh, të përballohet nga fondet e Bashkisë Ura Vajgure.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe të përfundojë me mbylljen e punimeve.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Ura Vajgure.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Ura Vajgure, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe Bashkia Ura Vajgure për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

Lista e shpronësimeve për projektin “Rehabilitimi urban i shesheve të fshatrave”

Nr.	Pronar	Përshkrimi	ZK	Nr.pasurisë	Sip.totale m ²	Lloji i pasurisë		Çmimi njësi	Vlera e shpronësimit	Konfirmuar ZVRPP-ja
						Truall	Arë			
1	Yzedin Shahini	sheshe-lulishte	1016	994/2	1300		1000	203	203000	po
2	Lavdosha Zana dhe	sheshe-lulishte	1427	169/3	2650		1000	203	203000	po
3	Dritan Zana									po
4	Lorenc Krimce	sheshe-lulishte	2349	51/17	1200	300		203	60900	po
5	Lorenc Krimce	sheshe-lulishte	2349	51/17	1200		350	203	71050	po
6	Ilirjan Gilava	sheshe-lulishte	3032	454/43	237.5	237.5		203	48212.5	po
7	Shefqet Gilava	sheshe-lulishte	3032	454/44	237.5	237.5		203	48212.5	po
8	Islam Gilava	sheshe-lulishte	3032	454/45	575	575		203	116725	po
								Totali	751100	

